



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË
BORDI

VENDIM

Nr. 252, Datë 21.12.2021

MBI

LËNIEN NË FUQI TË VENDIMEVE TË BORDIT TË ERE-S NR. 212, NR. 213
DHE NR. 214, DATË 15.12.2020

Në mbështetje të neneve 16, 19, 20, gërma “c”; 55, pika 1; nenit 83, nenit 85 dhe nenit 86, pika 6, të Ligjit nr. 43/2015, “Për Sektorin e Energjisë Elektrike”, i ndryshuar; Vendimit të Këshillit të Ministrave (VKM-së) nr. 244, datë 30.03.2016, “Për miratimin e kushteve për vendosjen e detyrimit të shërbimit publik, që do të zbatohen ndaj të licencuarve në sektorin e energjisë elektrike, të cilët ushtrojnë aktivitetin e prodhimit, transmetimit, shpërndarjes dhe furnizimit me energji elektrike”, e ndryshuar; neneve 15 dhe 19, pika 1, gërma “c”, të Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s, miratuar me vendimin e bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 96, datë 17.06.2016; Metodologjisë së Llogaritjes së Tarifave të Operatorit të Sistemit të Transmetimit të Energjisë Elektrike, miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 180, datë 08.11.2017; Metodologjisë së llogaritjes së tarifave të operatorit të sistemit të shpërndarjes së energjisë elektrike, miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 182, datë 10.11.2017 dhe Metodologjisë së Përcaktimit të Çmimeve për Shitjen e Energjisë Elektrike me Pakicë tek Klientët Fundorë që Furnizohen nga Furnizuesi i Shërbimit Universal (FSHU), miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr.189, datë 23.11.2017, bordi i ERE-s në mbledhjen e tij të datës 21.12.2021, mbasi shqyrtoi relacionin e përgatitur me nr. 156/8 prot., datë 17.12.2021, nga Drejtoria e Tarifave dhe Çmimeve, “Mbi lënien në fuqi të vendimeve të bordit të ERE-s nr. 212, nr. 213 dhe nr. 214, datë 15.12.2020”,

Konstatohet se:

ERE me vendimet e bordit nr. 180, datë 08.11.2017, nr. 182, datë 10.11.2017 dhe nr. 189, datë 23.11.2017, ka miratuar “Metodologjinë e Llogaritjes së Tarifave të Operatorit të Sistemit të Transmetimit të Energjisë Elektrike”, “Metodologjinë e Llogaritjes së Tarifave të Operatorit të Sistemit të Shpërndarjes së Energjisë Elektrike” dhe “Metodologjinë e Përcaktimit të Çmimeve për Shitjen e Energjisë Elektrike me Pakicë tek Klientët Fundorë që Furnizohen nga Furnizuesi i Shërbimit Universal”.

Në zbatim të pikës 1, të nenit 21, të Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s, miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.06.2016, i licencuari që kërkon përcaktimin e tarifave dhe çmimeve të shërbimeve të energjisë elektrike dhe të gazit natyror për vitin pasardhës duhet të paraqesë në ERE një kërkesë me shkrim të shoqëruar me të gjithë informacionin dhe dokumentacionin e kërkuar sipas kësaj rregullore dhe metodologjive përkatëse, jo më vonë se data 1 Shtator të vitit aktual.

Aplikimet e paraqitura nga operatorët e licencuar nga ERE duhet të shoqërohen me dokumentacionin përkatës sipas parashikimeve të nenit 22, të *Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s*, miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.06.2016 dhe “*Sistemit të njëhsuar dhe të standardizuar të llogarive për të licencuarit në sektorin e energjisë elektrike për aktivitetin e shpërndarjes dhe furnizuesit të shërbimit universal të energjisë elektrike*”, miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 244, datë 26.11.2018.

- Këshilli i Ministrave me anë të Vendimit nr. 584, datë 08.10.2021, ka vendosur shpalljen e gjendjes së emergjencës së furnizimit me energji elektrike. Ky vendim ndër të tjera përcaktonte një sërë detyrash ndaj OSHEE Group, OST sh.a. dhe KESH sh.a., të cilat lidhen me ndryshimet e çmimeve të importit të energjisë elektrike në tregun e lirë dhe sigurimin e furnizimit të pandërprerë të energjisë elektrike për klientët fundorë.

- **Lidhur me miratimin e tarifës së shërbimit të transmetimit të energjisë elektrike:**

- Bordi i ERE-s me vendimin nr. 212, datë 15.12.2020, vendosi lënien në fuqi të vendimit nr. 266, datë 21.12.2018, të bordit të ERE-s, në lidhje me tarifën e shërbimit të transmetimit të energjisë elektrike deri në aplikimin për përcaktimin e tarifave të shërbimit të transmetimit të energjisë elektrike nga shoqëria OST sh.a., në përputhje me kërkesat e metodologjisë së llogaritjes së tarifave të transmetimit të energjisë elektrike.
- Bazuar në detyrimet sipas akteve ligjore dhe nënligjore në fuqi, shoqëria OST sh.a. ka depozituar në ERE me shkresën nr. 5215 prot., datë 31.08.2021, aplikimin për shqyrtim të tarifave të OST sh.a. për vitin 2022 dhe periudhën 2022 - 2024.
- Në vijim të shpalljes së gjendjes së emergjencës së furnizimit me energji elektrike me VKM-në nr. 584, datë 08.10.2021, shoqëria OST sh.a. me shkresën nr. 5215/1 prot., datë 05.10.2021, ka depozituar në ERE kërkesën për përditësim të aplikimit për tarifën e OST sh.a. për vitin 2022 dhe periudhën 2022-2024.
- ERE me anë të shkresës nr. 914/2 prot., datë 11.10.2021, kërkoi nga OST sh.a. përpara marrjes së një vendimi lidhur me aplikimin e saj, që aplikimi i shoqërisë të konsideronte përditësimin e të dhënave sipas parashikimeve të VKM-së nr. 584, datë 08.10.2021, si dhe listoi disa nga kërkesat thelbësore të metodologjisë, të cilat shoqëria OST sh.a. duhet t'i përmbushte dhe t'i përcillte në ERE.
- Shoqëria OST sh.a. me anë të shkresës nr. 5215/3 prot., datë 04.11.2021, i është përgjigjur tonës me nr. 914/2 prot., datë 11.10.2021, duke përcjellë të dhëna dhe dokumente të cilat kanë shërbyer për përditësimin e përlllogaritjeve të saj sa i takon aplikimit të përcjellë me shkresën nr. 5215 prot., datë 31.08.2021, të tarifës mesatare të propozuar për periudhën rregullatore 2022-2024, si dhe plotësimin në vija të përgjithshme të kërkesave të listuara nga ERE.
- Bordi i ERE-s me vendimin nr. 234, datë 19.11.2021, vendosi “Fillimin e procedurës për shqyrtimin e aplikimit të shoqërisë OST sh.a. për tarifën e transmetimit të energjisë elektrike për vitin 2022 dhe periudhën 2022-2024”.

- Në vijim të procedurave me Urdhrin e Kryetarit të ERE-s nr. 86, datë 26.11.2021, u zhvillua një seancë teknike midis përfaqësuesve të ERE-s dhe të shoqërisë OST sh.a. për diskutime mbi procesin e shqyrtimit të aplikimit për përcaktimin për tarifën e operatorit të sistemit të transmetimit për vitin 2022 dhe periudhën 2022-2024.
 - Gjatë procedurave të shqyrtimit të aplikimeve për tarifë, ERE ka vijuar korrespondencat me të licencuarit për sa i përket plotësimeve të kërkesave dhe informacioneve në zbatim të Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s, miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.06.2016.
 - Në përputhje me pikën 7, të nenit 22, të Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s, miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.06.2016, ERE do të zhvillojë më datë 29.12.2021, një seancë dëgjimore publike me shoqërinë OST sh.a. lidhur me aplikimin për përcaktimin e tarifës së OST sh.a. për vitin 2022 dhe periudhën 2022-2024.
 - Në mënyrë që shoqëria OST sh.a. edhe për vitin 2022, të mundet të realizojë aktivitetin për të cilin është licencuar, konform Ligjit nr. 43/2015, “Për Sektorin e Energjisë Elektrike”, i ndryshuar, bëhet e domosdoshme të vijojë faturimin bazuar në tarifën e miratuar nga ERE.
- **Lidhur me miratimin e tarifës së shërbimit të shpërndarjes së energjisë elektrike:**
- Bordi i ERE-s me vendimin nr. 213, datë 15.12.2020, vendosi të shtyjë fuqinë juridike të vendimit të bordit të ERE-s nr. 199, datë 12.12.2019, deri në miratimin e një vendimi mbështetur në aplikimin e shoqërisë OSSH sh.a. për vitin 2021, në përputhje me kërkesat e akteve ligjore dhe nënligjore në fuqi.
 - Bazuar në detyrimet sipas akteve ligjore dhe nënligjore në fuqi, shoqëria OSSH sh.a. ka depozituar në ERE me shkresën nr. 8016 prot., datë 03.09.2021, aplikimin për shqyrtim të tarifave të OSSH sh.a. për vitin 2022.
 - Në vijim të shpalljes së gjendjes së emergjencës së furnizimit me energji elektrike me VKM-në nr. 584, datë 08.10.2021, shoqëria OSSH sh.a. me shkresën nr. 8016/1 prot., datë 30.09.2021, ka depozituar në ERE kërkesën për përditësim të aplikimit për tarifa të shpërndarjes, sipas shkresës nr. 8016 prot., datë 03.09.2021, në kushtet e ndryshimeve të menjëhershme të parashikimeve bazë.
 - ERE me anë të shkresës nr. 925/2 prot., datë 11.10.2021, kërkoi nga OSSH sh.a. përpara marrjes së një vendimi lidhur me aplikimin e saj që aplikimi i shoqërisë të konsideronte përditësimin e të dhënave sipas parashikimeve të VKM-së nr. 584, datë 08.10.2021, lidhur me shpalljen e gjendjes së emergjencës në furnizimin me energji elektrike, si dhe listoi disa nga kërkesat thelbësore të metodologjisë, të cilat shoqëria OSSH sh.a. duhet t'i përmbushte dhe t'i përcillte në ERE.
 - Shoqëria OSSH sh.a. me anë të shkresës nr. 8016/3 prot., datë 18.10.2021, ka depozituar në ERE aplikimin e përditësuar për tarifa të OSSH sh.a. për vitin 2022.
 - Bordi i ERE-s me vendimin nr. 233, datë 19.11.2021, vendosi fillimin e procedurës për shqyrtimin e aplikimit të tarifave të OSSH sh.a. për vitin 2022.

- Në vijim të procedurave me Urdhrin e Kryetarit të ERE-s nr. 87, datë 26.11.2021, u zhvillua një seancë teknike midis përfaqësuesve të ERE-s dhe të shoqërisë OSSH sh.a. për diskutime mbi procesin e shqyrtimit të aplikimit për përcaktimin për tarifën e OSSH sh.a. për vitin 2022.
 - Gjatë procesit të shqyrtimit të aplikimeve për tarife, ERE ka vijuar korrespondencat me të licencuarin përsa i përket plotësimeve të kërkesave dhe informacionet në zbatim të Rregullores për organizimin, funksionimin dhe proçedurat e ERE-s, miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.06.2016.
 - Në përputhje me pikën 7, të nenit 22, të Rregullores për organizimin, funksionimin dhe proçedurat e ERE-s, miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.06.2016, ERE do të zhvillojë më datë 29.12.2021, një seancë dëgjimore publike me shoqërinë OSSH sh.a. lidhur me aplikimin për përcaktimin për tarifën e OSSH sh.a. për vitin 2022.
 - Shoqëria OSSH sh.a., në vijim të aplikimit të tarifave për vitin 2022, ka paraqitur në ERE me shkresën nr. 10691 prot., datë 14.12.2021, protokolluar me tonën me nr. 925/9 prot., datë 15.12.2021, materiale plotësuese në lidhje me aplikimin e përditësuar për tarifa OSSH sh.a. për vitin 2022.
 - Në përputhje me pikën 7, të nenit 22, të Rregullores për organizimin, funksionimin dhe proçedurat e ERE-s, miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.06.2016, ERE do të zhvillojë seanca dëgjimore publike dhe konsultimi lidhur me aplikimin për përcaktimin e tarifave të OSSH sh.a. për vitin 2022.
 - Në mënyrë që shoqëria OSSH sh.a. edhe për vitin 2022, të mundet të realizojë aktivitetin për të cilat është licencuar, konform ligjit nr. 43/2015, “Për Sektorin e Energjisë Elektrike”, i ndryshuar, bëhet e domosdoshme të vijojë faturimin bazuar në tarifat e miratuara nga ERE.
- **Lidhur me miratimin e çmimeve me pakicë për klientët fundorë që shërbehen nga furnizuesi i shërbimit universal:**
- Bordi i ERE-s me vendimin nr. 214, datë 15.12.2020, vendosi të shtyjë fuqinë juridike të vendimit të bordit të ERE-s nr. 200, datë 12.12.2019, deri në miratimin e një vendimi mbështetur në aplikimin e shoqërisë FSHU sh.a. për vitin 2021, në përputhje me kërkesat e akteve ligjore dhe nënligjore në fuqi.
 - Shoqëria FSHU sh.a. nuk ka paraqitur pranë ERE-s aplikim për miratimin e çmimeve me pakicë për klientët fundorë që shërbehen nga furnizuesi i shërbimit universal, bazuar në detyrimet sipas legjislacionit në fuqi.
 - ERE me vendimet e bordit nr. 233 dhe nr. 234, datë 19.11.2021, ka vendosur fillimin e procedurës për shqyrtimin e aplikimit të tarifave të OSSH sh.a. për vitin 2022 dhe shqyrtimin e aplikimit të shoqërisë OST sh.a. për tarifën e transmetimit të energjisë elektrike për vitin 2022 dhe periudhën 2022-2024.
 - ERE me anë të shkresës nr. 925/4 prot., datë 16.11.2021, me lëndë “Mbi çmimet e shitjes së energjisë elektrike për vitin 2022”, ka njoftuar shoqërinë FSHU sh.a. mbi aplikimet për tarifa të rrjetit nga operatorët e transmetimit dhe shpërndarjes dhe ka kërkuar nga shoqëria FSHU sh.a. të përcjellë një set të dhënash dhe informacionesh, ku përfshihen ndër të tjera: i)

pritshmëria e shoqërisë FSHU sh.a. mbi transferimin e kostove të rrjetit të kërkuara nga operatorët, kostove të blerjes së energjisë dhe kostot e tjera të aktivitetit të shoqërisë për çdo kategori klientësh që do të furnizohen nga FSHU sh.a. gjatë vitit 2022 dhe ii) strukturën e çmimeve që pritet të aplikohen nga shoqëria për të përfituar të ardhurat e nevojshme për mbulimin e kostove të aktivitetit ushtrimor të parashikuara për vitin 2022.

- Shoqëria FSHU sh.a. me shkresën nr. 10420 prot., datë 06.12.2021, në përgjigje të shkresës nr. 925/4 prot., datë 16.11.2021, ndër të tjera ka theksuar se FSHU sh.a. është në pritje të vendimeve të ERE për tarifën dhe çmimet lidhur me transferimin e kostove të rrjetit për klientët tariforë dhe mbështetur në vendimet dhe deklaratat e Qeverisë së Shqipërisë, FSHU sh.a. pret mos ndryshim të çmimeve të shitjes së energjisë për klientët në nivelin e tensionit 0.4 kv.
- Në mënyrë që shoqëria FSHU sh.a. edhe për vitin 2022, të mundet të realizojë aktivitetin për të cilin është licencuar, konform ligjit nr. 43/2015, “Për Sektorin e Energjisë Elektrike”, i ndryshuar, bëhet e domosdoshme të vijojë faturimin bazuar në çmimet në fuqi të miratuara nga ERE.

Për gjithë sa më sipër, bordi i ERE-s,

Vendosi:

1. Të shtyjë fuqinë juridike të vendimit të bordit të ERE-s nr. 212, datë 15.12.2020, deri në përfundimin e procedurës për shqyrtimin e aplikimit të shoqërisë OST sh.a. për tarifën e transmetimit të energjisë elektrike për vitin 2022 dhe periudhën 2022-2024, miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 234, datë 19.11.2021.
2. Të shtyjë fuqinë juridike të vendimit të bordit të ERE-s nr. 213, datë 15.12.2020, deri në përfundimin e procedurës për shqyrtimin e aplikimit të shoqërisë OSSH sh.a. për tarifën e shpërndarjes së energjisë elektrike për vitin 2022, miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 233, datë 19.11.2021.
3. Të shtyjë fuqinë juridike të vendimit të bordit të ERE-s nr. 214, datë 15.12.2020, deri në vlerësimin e ERE për transferimin e kostove të transmetimit dhe shpërndarjes së energjisë elektrike të çmimet e shitjes me pakicë të klientëve fundorë që shërbehen nga Furnizuesi i Shërbimit Universal në përputhje me kërkesat e akteve ligjore dhe nënligjore në fuqi. (tabela bashkëlidhur këtij vendimi).
4. Klientët të cilët kanë plotësuar kushtet ligjore dhe /ose teknike për daljen në tregun e liberalizuar të energjisë elektrike nuk janë subjekt i parashikimeve të pikës 3, të këtij vendimi.
5. Nëse do të ketë efekte në të ardhurat e shoqërive, do të bëhet korrigjimi dhe kompensimi përkatës i tyre, në përputhje me përcaktimet e nenit 20, gërma “c”, të ligjit nr. 43/2015, “Për Sektorin e Energjisë Elektrike”, i ndryshuar dhe metodologjive përkatëse, të miratuara nga ERE.

6. Drejtoria e Tarifave dhe Çmimeve, të njoftojë palët e interesit për vendimin e bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe i fillon efektet nga data 1 janar 2022.

Për këtë vendim mund të kërkohet rishikim në ERE brenda 7 ditëve kalendarike si dhe mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI

Petrit AHMETI

**ÇMIMET E SHITJES ME PAKICË TË ENERGJISË ELEKTRIKE PËR KLIENTËT
FUNDORË QË SHËRBEHEN NGA FURNIZUESI I SHËRBIMIT UNIVERSAL**

Përshkrimi	Çmimi aktive (Leke/kWh)	Çmimi pik (Leke/kWh)
Çmimi i shitjes për Klientët në 20 kV	11	12.65
Çmimi i shitjes për Klientët në 10/6 kV	11	12.65
Furra buke dhe prodhim mielli në 10/6 kV	7.1	8.17
Çmimi i shitjes për Klientët e lidhur në TM dhe me matës në TU	12.4	14.3
Klientë në 0.4 kV	14	16.1
Furra buke dhe prodhim mielli në 0.4 kV	7.6	8.74
Objekte kulti/bashkësi fetare	9.5	
Familjarë	9.5	
Çmimi për konsumin e energjisë elektrike në ambientet e përbashkëta (ndriçim shkalle, pompe, ashensor)	9.5	
Tarifë fikse e shërbimit për leximin "zero" (Leke/Muaj)	200	
<i>*Çmimi i energjisë reaktive është sa 15% e çmimit të rregulluar të furnizimit publik për kWh energji elektrike aktive sipas nivelit përkatës të tensionit.</i>		
<i>*Orari pik gjatë të cilit do të aplikohet çmimi për energjinë e konsumuar në pik është :</i>		
<i>Për periudhën 1 Nëntor - 31 Mars nga ora 18:00 deri në 22:00</i>		
<i>Për periudhën 1 Prill - 31 Tetor nga ora 19:00 deri në 23:00</i>		